

Pse vetëvendosje?

Vetëvendosja është e drejtë e të gjithë popujve të kolonizuar.

Mungesa e përgatitjes në fushat politike, ekonomike, shoqërore, apo në atë të arsimit kurrë nuk duhet të merret si pretekst për të vonuar pavarësinë. (Rezoluta 1514 e OKB-së, më 1960)

VETËVENDOSJE!
<http://www.vetevendosje.org>

Fletushkë e Lëvizjes VETËVENDOSJE!

- Pse Deklarata e Shpalljes së Pavarësisë nuk na e solli pavarësinë?
- EULEX-i mbi ligjin

Pse Deklarata e Shpalljes së Pavarësisë nuk na e solli pavarësinë?

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës e 17 shkurtit 2008 ishte një hap përpara, për shkak të njohjes ndërkombëtare. Por, në të njëjtën kohë, kjo deklaratë paraqet tre hapa mbrapa, sepse është e lidhur me zbatimin e Planit të Ahtisaar-it, mbikëqyrjen ekzekutive prej dy misionëve ndërkombëtare mbi bazën e Rezolutës 1244, dhe sepse ia mundësoi Serbisë zgjerimin e kontrollit brenda Kosovës.

Plani i Ahtisaar-it: Deklarata e shtrëngon Kosovën për ta zbatuar Planin e Ahtisaar-it, i cili e ndan vendin tonë mbi baza etnike. Ai krijon brenda Kosovës një entitet territorial serb përmes 'decentralizimit', që do të kishte lidhje vertikale me institucionet e Beogradit. Po ashtu, ky plan të gjithë trashëgiminë ortodokse të Kosovës e definon si 'serbe', duke na shpronësuar prej kulturës sonë dhe duke na ndarë mbi baza fetare. Ai ia mohon Kosovës pasjen e ushtrie për ta mbrojtur veten, kurse Serbisë ia mundëson zhvillimin e mekanizmave për ta mbrojtur kontrollin e saj brenda Kosovës. Plani u mendua të ishte çmim që duhet t'ia paguanim Serbisë në shkëmbim të njohjes së pavarësisë. Institucionet po e zbatojnë Planin pa na njohur Serbia.

Mbikëqyrja ndërkombëtare dhe Rezoluta 1244: Deklarata përfshiu një ftesë drejtuar dy misionëve ndërkombëtare për mbikëqyrjen dhe zbatimin e Planit të Ahtisaar-it dhe sundimin e ligjit. Asnjëri prej tyre nuk ka rol këshillues. Këto misione – Zyra Civile Ndërkombëtare (ICO) dhe EULEX-i – kanë pushtet ekzekutiv dhe nuk i japin llogari e përgjegjësi institucioneve të Kosovës. Ato janë ligji i vërtetë sepse qëndrojnë mbi ligjin. Vetëm misioni EULEX do të shpenzojë 364 milion euro vetëm në vitin e parë. Ne nuk duam policë. Pse të mos shfrytëzohet këto para për ta përmirësuar arsimin dhe sistemin shëndetësor?

Deklarata po ashtu përmban zotimin e veprimt në përputhje me parimet e Rezolutës 1244, e cila ish Republikës Federale të Jugosllavisë (tash Serbisë) ia njeht sovranitetin dhe integritetin territorial mbi Kosovën! Si rrjedhim, UNMIK-u është ende këtu, kurse policët e shteteve të ndryshme që

Nr.134, 16 shkurt 2009

kundërshtojnë pavarësinë e Kosovës, siç është Rumania, janë lejuar që të shërbejnë këtu. EULEX-i 'neutral ndaj statusit' edhe pse ka arshur këtu për ta zbatuar ligjin nuk e njeht zyrtarisht Kushtetutën e Kosovës!

Strategjia e Serbisë brenda Kosovës: Përderisa institucionet e Kosovës po e festonin deklaratën dhe po përqendroheshin në njohjet e reja, Serbia po e planifikonte zbatimin e strategjisë së vet e cila ka qy qëllime:

1. **Mënjanimin e kufirit zyrtar ndërmjet Kosovës e Serbisë dhe forcimin e kufirit të ri në lumin Ibër.** Këtë synim Serbia e ka arritur duke i djegur pikat doganore ndërmjet Serbisë dhe Kosovës. Që prej asaj dite, pikat doganore kanë funksionuar 54 km në jug afër Mitrovicës. Duke u siguruar që EULEX-i është 'neutral ndaj statusit' dhe vepron në përputhje me Rezolutën 1244, ky kufi zyrtarisht ende definohet si 'kufi administrativ', e jo kufi ndërkombëtar. Dhe së fundi, duke organizuar sulme të organizuara të dhunshme mbi shqiptarët në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, dhe pa asnjë përndjekje a denim, strukturat paralele të Serbisë treguan që autoriteti i institucioneve të Kosovës nuk shkon matanë lumit Ibër.

2. **Forcimin e institucioneve dhe strukturave të Serbisë brenda Kosovës në mënyrë t'i krijojë themelet e entitetit territorial dhe institucional autonom serb.** Serbia ia ka arritur kësaj duke bojkotuar ShPK-në e cila i raporton institucioneve të Kosovës; duke i okupuar institucionet tjera si hekurudhat dhe gjykatat; si dhe duke i zgjedhur strukturat paralele serbe nëpërmjet zgjedhjeve nacionale dhe lokale të Serbisë të mbajtura brenda Kosovës më 11 maj 2008. Edhe pse UNMIK-u tha që nuk do t'i njeht këto struktura të reja, ata po plotësisht po bashkëpunojnë me këto struktura.

Serbia është shpërblyer për këtë strategji, duke i ofruar asaj më shumë negociata të cilat çuan në Planin 6-Pikësh, e i cili shkon përtej Planit të Ahtisaarit dhe i cili edhe më tutje e ndan Kosovën territorialisht dhe institucionalisht. Dhe sikur kjo të mos mjaftonte, Serbisë me siguri që së shpejti do t'i ofrohet statusi i kandidatit për në BE.

Në mënyrë që të jemi sovran e të pavarur, me integritet territorial e demokraci, ne duhet të kemi:

- Të drejtën për të pasur ushtri
- Kontrollimin e policisë sonë
- Kontrollimin e burimeve tona dhe një plan ekonomik për zhvillim energjetik dhe të bujqësisë
- Qeverisje pa ndërhyrje nga misionet ndërkombëtare ekzekutive
- Refuzimin e Planit të Ahtisaar-it dhe Planit 6-Pikësh
- Arrestimin dhe shpërbërjen e strukturave të paligjshme paralele të Serbisë

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, Tina Kaidanow, insistoi që Kosova dhe Serbia t'i fillojnë bisedimet, qoftë edhe të tërthorta. Gazeta Express e datës 14 shkurt.

EULEX-i mbi ligjin

Gazetat e javës së kaluar raportuan se Zëvendës shefi i Ekipit Planifikues të BE-së, Alessio Zuccarini, kishte pasur një fatkeqësi komunikacioni më 25 nëntor në qendër të Prishtinës, pas të cilit ai kishte refuzuar të bashkëpunonte me Policinë e Kosovës, që kishte ardhur në vendin e ngjarjes. Edhe pse lënda u ishte dërguar gjykatave të Kosovës për shqyrtim, ajo më pas ishte marrë nga gjykatësit e EULEX-it, siç thuhet, me kërkesë të Yves de Kermabon, ngase Zuccarini mbrohet me imunitet. Disa burime thonë se ai është shkarkuar nga pozita e tij, të tjera thonë se ka mbetur (në pozitë). Dy qendra mediale thonë se janë kërcënuar për të mos e mbuluar ngjarjen.

Përveç kësaj, gazetat raportuan këtë javë se EULEX-i po e heton personelin e vet në bazë të akuzave për korrupsion. Siç thuhet, dy punëtorë lokalë u kanë dhënë mito me vlerë prej 5,000 eurosh personelit ndërkombëtar për të siguruar vende të punës në EULEX.

EULEX-i ka po ato vetura, po atë ndërtesë dhe puthuajse të njejtin personel që kishte UNMIK-u, dhe është themeluar në po atë bazë ligjore si UNMIK-u. Nuk është për t'u çuditur fakti se punëtorët e EULEX-it, ashtu si UNMIK-u, tashmë kanë filluar të tregojnë se si besojnë që ata janë mbi ligjin – se kanë ardhur këtu për ta zbatuar atë (ligjin) për ne, por jo edhe për veten e tyre.